

PROCEDURA DHE DOKUMENTACIONI QË DUHET PLOTËSUAR PËR TU TRAJTUAR ME PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL BANESË ME KOSTO TË ULËT DUKE PËRFITUAR KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI .

Bazuar në ligjin nr.22/18 “ Për strehimin Social “ i ndryshuar ,ligjit nr.139/2015 “ Për Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, VKM nr.384,datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore “ , VKM nr.453,datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët ,me kredi të lehtësuara nga shteti, VKM nr.852,dt 26.12.2024 “Për procedurën e paraqitjes së kërkesës ,afatet kohore,përgjegjësistë dhe rolet e përdoruesve të sistemit për përfitimin nga programet e strehimit social” ,duhet të ndiqet kjo procedure :

I.APLIKIMI PËR PËRFITIMIN E PROGRAMIT SOCIAL KRYHET ON-LINE NË PORTALIN UNIK QEVERTAR “E-ALBANIA”.

DOKUMENTACIONI PËR TË PËRFITUAR SUBVENCIONIM TE INTERESAVE TË KREDISE ËSHTË SI MË POSHTË DHE PËRBËHET NGA:

II. Për të dhëna personale të aplikantit:

1. Fotokopje të kartës së identitetit së aplikantit.
- 2.Çertifikaten familjare ne momentin e aplikimit.
3. Vërtetim për vendbanimin (te Administratori i lagjes apo /Njesisë Administrative)
- 4.Statusin e punesimit te aplikuesit(punesuar ne shtet ,privat , apo i vetpunesuar)

III. Për vërtetimin e kushteve të strehimit sipas shkronjës “a” të nenit 16,të ligjit nr,22/2018 “|Për strehimin social”;

- 1.vërtetimin negativ nga nga ASHK (Agjencia Shteterore e Kadastres), që në emër të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes ,**nuk figuron ,në të gjithë territorin e Shqipërisë, pronë e regjistruar ose në proces regjistrimi ose vërtetimin për një pronë që është nën normat e banimit.**
- 2.banoj ne banesa qe paraqesin rrezik shembjeje ;
- 3.banoj ne banesa të mbipopulluara sipas percaktimeve dhe normave në fuqi;
- 4.kane mbetur te pastrehe si rezultat i fatkeqesive natyrore ;
- 5.banojne ne banesa që prishen apo perjashtohen nga procesi i legalizimit ,si rezultat i investimeve publike.

IV. Për vërtetimin e kushteve familjare, sipas shkronjës “b”, të nenit 16 të ligjit 22/2018 “|Për strehimin social”;

- 1.familjet njeprinderore qe kane ne ngarkim femije ,ku perfshihen vajzat nena;
- 2.kopje te vendimit të gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara;
- 3.familje e re do te quhen ato familje kur mosha e anetarit me te madh te te ciles ne momentin e paraqitjes se kerkeses , eshte me e vogel ose baras me 40 vjeç;
- 4.familjet me me shume se kater femije ;

V. Për vërtetimin e kushteve sociale ,sipas shkronjës “c”, të nenit 16, të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”;

- 1.vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi të kufizuara ;
- 2.individe me statusin e jetimit,qe nga çasti I daljes nga qendrat e perkujdesjes shoqerore dhe dei ne moshen 30 vjeç;
- 3.emigrantet e rikthyer
- 4.viktimat e dhunes ne familje
- 5.familjet e policeve te rene ne detyre ;
- 6.anetare te komunitetit rom dhe egjiptian;
- 7.vajzat nena ;
- 8.punonjesit e sherbinit te mbrojtjes nga zjarri ;

VI. Për vërtetimin e kushteve ekonomike,:

1. vërtetim i të ardhurave neto të familjes, për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t'i bashkëlidhen dokumenteve zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, në moshë madhore që janë në marrëdhënie pune;
2. dokument nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;
- 3.vertetimin per masen e pensionit per personat e familjes qe jane ne pension;
- 4.vertetimin per personat qe jane punekerkes te papune;
- 5.vertetimin e fitimit te te ardhurave nga biznesi te vitit te fundit per personat e vetpunesuar;
- 6.vërtetim nga drejtoria e taksave të bashkisë , që aplikuesi nuk ka detyrime për taksat dhe tarifat vendore;**
7. vertetim nga bankat për gjendjen e llogarive dhe të depozitave të familjes /individit.

Shënim; Dokumentat e sipërcituar t'i bashkelidhen aplikimit per kredi te zbutur 3% ose të dorëzohen pranë protokollit të Bashkisë brenda datës **31.03.2025**

**KRITERI I TE ARDHURAVE QE DUHET TE PLOTESOJE ÇDO APLIKUES PER T'U
TRAJTUAR ME KREDI TE ZBUTUR 3%.**

Niveli i të ardhurave familjare mujore për t'u trajtuar me kredi me interes 3% / vit në nivel qarku sipas madhësisë së familjes per vitin 2024 sipas të dhënave të INSTAT të vitit 2023.

Qarku	Familje me 1 person	Familje me 2 persona	Familje me 3 persona	Familje me 4 persona	Familje me 5+ persona	Shpenzime mesatare mujore per konsum
Berat mini	45,738	71,643	78,561	101,527	104,888	83,006
Berat. max	54,886	85,972	94,273	121,832	125,866	99,607

Shenim : Kalimi i kufirit maksimal te te ardhurave familjare mujore sipas përbërjes familjare është kriter s'kualifikues për këtë program strehimi.

Shuma e kredisë për familje sipas VKM nr.268,dt 29.04.2022 “Per disa ndryshime te VKM nr.453,dt 3.7.2019

Nr	Qyteti	Struktura familjes (nr.persona)	Struktura e Ap	Siperfaqja takuese	Kufiri Maksimal i Kredise/ mbas daljes se vkm nr.268,dt 29.4.2022”Per disa ndryshime te vkm nr.453,dt3.7.2019
1	Berat	1	Garsoniere	45	2,349,000
		2	1+1	55	2,871,000
		3-4	2+1	81	4,228,200
		4-5	3+1	100	5,220,000